

Projekti EU4Rivers




SHTRIRJA E PROJEKTIT
SHQIPËRI



PËRFITUES
AMBU/AKM/SHGJSH/
IGJEO/ISHP




FINANCIMI
Totali: 10.39 milionë euro



KOHËZGJATJA E PROJEKTIT
TETOR 2023- SHTATOR 2028



DONATORI:
BE & ADA (pjesë e
International
Partnerships Austria)



STATUSI KORRIK 2026
PROJEKT NË ZBATIM



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti “EU4Rivers” është një projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), i zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), pjesë e International Partnerships Austria. Ky projekt përbën Komponentin 1 të Programit të BE-së për Ujin (EU for Water) dhe financohet në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III). Objektivi specifik i projektit është të rrisë përafrimin e Shqipërisë me acquis të BE-së për ujin.

Projekti do të kontribuojë në:

1. Kuadri gjithëpërfshirës ligjor dhe institucional për Menaxhimin e Integruar të Ujit është përmirësuar në mënyrë thelbësore në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së për ujin.
 2. Zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore në të gjitha basenet lumore është rritur në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit.
 3. Monitorimi i ujit, raportimi dhe zbatimi janë përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në përputhje me kërkesat e acquis-së së BE-së për ujin.
 4. Krijimi i kuadrit strategjik dhe institucional për Zbatimin e Direktivës Kuadër të Strategjisë Detare të BE-së (MSFD).
- Përmirësimin e kapacitetit monitorues të trupave ujorë në basene specifike lumore (laboratorë, stacione monitorimi, logjistikë, burime njerëzore, trajnime dhe disponueshmëri buxhetore) në mënyrë që të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme statusi fizik, kimik dhe ekologjik i burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.
 - Rritjen e kapaciteteve për zbatimin e kërkesave të DKU-së dhe përgatitjen e PMBL-ve, duke përfshirë kapacitetet menaxhuese dhe mjetet operative të aktorëve kryesorë të ujit.
 - Forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e kërkesave të Direktivës Kuadër për Strategjinë Detare (MSFD), përmes zhvillimit të Strategjive Detare për Detin Adriatik dhe Jon.